



VENDIM

NR.55 DATË 23.04.2015

PËR

FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “NISHOVA ENERGY” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NISHOVA” ME FUQI TOTALE 1.36 MW.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”; 5 pika 1 gërma “a”; 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.04.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “NISHOVA ENERGY” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, me fuqi totale 1,36 MW.

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KISI-BIO-ENERGJI” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1, Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte

Neni 9, pika 2 Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronesor është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar pjesërisht

Neni 9, pika 4.1.1 është plotësuar teresisht.

Neni 9, pika 4.1.2 , është plotësuar teresisht.

Neni 9, pika 4.1.3 , është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 4.1.4 , dokumentacioni tekniko- ekonomik është plotësuar pjesërisht

Neni 9, pika 4.1.5, leje nga institucione të tjera, është plotësuar teresisht.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plote/te Pjesëhem dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, të paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për liçensimin e shoqërisë “NISHOVA ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “NISHOVA” me fuqi totale 1,36 MW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për:

VENDIM

NR.55 DATË 23.04.2015

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“NISHOVA ENERGY” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“NISHOVA” ME FUQI TOTALE 1,36 MW.**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Abaz Aliko

Entela Shehaj

Maksim Shuli
